




Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KUVENDI KOMUNAL/ASSEMBLY OF MUNICIPALITY/SKUPŠTINA OPŠTINA
SKENDERAJ

Nr. 04-060/01-0022162/25
Data 11-06-2025



Komuna Skenderaj
Opština Skenderaj
Municipality of Skenderaj

Procesverbal nga dëgjimi buxhetor për kornizën afatmesme buxhetore KAB 2026-2028

Data: 03.06.2025

Ora: 13:30

Vendi: SHFMU "Dëshmorët e Qyqavicës", Qirez

Të pranishëm: Drejtori për Buxhet dhe Financa, z. Ismet Aliu; Drejtori i Urbanizmit dhe Mbrojtjes së Ambientit, z. Driton Mulaj; Drejtori për Shërbime Publike, z. Alban Shala; Drejtori i Arsimit z. Kastriot Duraku.

Ismet Aliu: Përshëndetje për të gjithë. Siç e shoh, pak ka të interesuar për të marrë pjesë në këtë dëgjim buxhetor, por ne si ekzekutiv i komunës jemi të obliguar të respektojmë procedurat ligjore. Kryetari i Komunës, për shkak të agjendës së tij nuk ka mundur të marrë pjesë, ne jemi të deleguar në emër të tij. Jemi në një proces të hartimit të buxhetit, është një në fazë që nga tash deri në shtatori, ne bëjmë hartimin e shpenzimeve të buxhetit dhe jemi të obliguar të marrim propozime nga qytetarët për projektet që janë në interes të tyre dhe brenda mundësive financiare t'i inkorporojmë në buxhet. Siç e keni parë në njoftimin tonë, ne i kemi marrë disa informata nga Ministria e Financave se sa mund të jetë buxheti për 2026, 2027 dhe 2028. Përafërsisht 4.160.000,00 € pritet të kemi buxhet për projekte për vitin 2026. Ne si komunë pas regjistrimit të popullsisë kemi buxhet më të vogël për shkak të zvogëlimit të popullsisë, ku kemi dhe zvogëlim të nxënësve, ku si kriter kryesor për ndarjen e buxhetit nëpër komuna është popullsia 89%.

Ne kemi ardhur për t'ju dëgjuar ju, nëse ka dikush ndonjë propozim që do të mundohemi ta përfshijm në buxhet.

Ismet Ademi nga Kozhica: Desha të pyes për fshatin Kozhicë, a ka ndonjë projekt në këtë vit apo në vitin 2026 për këtë fshat, pasi nuk kemi ndriçim publik, ujësjellës, si dhe rruga Kozhicë-Qyqavicë ka filluar por nuk ka përfunduar, a ka diçka të planifikuar për këtë fshat ?

Afrim Rama nga Qirezi: Desha të pyes për trotuar, pasi që lagjja jonë nuk ka as edhe një 1 metër trotuar?

Amir Ferati, Drejtor i Shkollës SHFMU "Dëshmorët e Qyqavicës": Desha ta propozoj

çështjen e rrethojës së shkollës dhe oborrit të shkollës, pasi që është interes i të gjithëve.

Ismet Ademi nga Kozhica: Deshta të ngre edhe një çështje tjetër për një situatë me kanalizimin te lagjja Jasharaj në Kozhicë, pasi ka dalur kanalizimi në një arë dhe kundërmon shumë, është nevojë e domosdoshme të rregullohet.

Driton Mulaj: Sa i përket kanalizimit, siç ka premtuar edhe kryetari, tash kompania është në fshatin Qubrel, sapo ka përfunduar, pasi që në këtë fshat kemi hasur me disa telashe, por i kemi përfunduar. Dhe nuk kemi mundur të vijmë papërfunduar këtë fshat, kështu që para fundit të muajit qershor do të fillojë edhe sanimi i problemit në këto pjesë.

Driton Mulaj: Sa i përket rrugës Kozhicë–Qyqavicë, po shpresojmë që javën e ardhshme të fillojmë, sot i kemi bërë disa teste te rrugëve dhe do ta rregullojmë gjendjen këtu në këtë pjesë të papërfunduar. Edhe rruga Kozhicë–Qyqavicë, por vetëm deri te pjesa ku është hapur, jo më lart për shkak se duhet pëlqim nga Agjencioni i Pylltarisë.

Driton Mulaj: Ujësjetësin jemi duke e shtrirë gypin kryesor, por ujë nuk do të ketë pasi që është projekt i madh dhe është problem furnizimi me keto kapacitete.

Driton Mulaj: Ndriçimi publik është duke u rregulluar në shumë fshatra. Jemi duke punuar me tre ekipe nëpër fshatra, dhe nuk po mund të dalim nga një pjesë papërfunduar në të gjitha lagjet, por gradualisht do të vijmë edhe në këto pjesë.

Driton Mulaj: Për trotuar e kemi në kuadër të fshatit Qirez, një pjesë kogja të mirë. I kemi dhënë prioritet për shkak së vitin e kaluar Agjencioni i Privatizimit na ka ndaluar rregullimin e subqendres, për shkak të pronës, do ta bëjmë një riformatim të projektit, dhe po planifikojmë që mbas ambulances ktu ta vendosim një muri të betonit, pasi ka rrezik të rrëshqitjes.


Kastriot Duraku: Rrethojën e kemi diskutuar me drejtorin disa herë, por këtë vit është problem të punohet diçka. Por për vitin e ardhshëm, si projekt është i qelluar, këtë vit janë planifikuar 6 rrethoja në shkollë të ndryshme por për shkak të kontratës kolektive është problem këtë vit të rregullojmë diçka. Vitin e ardhshëm në rast se nuk kemi telashe me kontratën kolektive do ta realizojmë, pasi nuk është vlerë e madhe dhe e kemi të kontraktuar kompaninë. Oborrit e shkollës bashkë me DUMA do të na ndihmojë me operatorin që është duke e rregulluar subqendrën për ndonjë rregullim në oborr.


Ismet Aliu: Faleminderit drejtor. Dikush tjetër, a do ta marrë fjalën? Nëse nuk ka, ne ju dëgjuam ju për kërkesat e juaja për këto projekte, ne do t'i marrim të gjitha kërkesat nga bashkësitë lokale dhe do mundohemi t'i përfshijmë në buxhet. Disa i kemi në vitin 2026, por mund t'i parashikojmë edhe në vitin 2027 dhe 2028. Deri në shtator jemi në këtë fazë që kemi me i

shqyrtu të gjitha kërkesat derisa t'ia dorëzojmë Kuvendit Komunal për aprovim.

Ju faleminderit për pjesëmarrje, shihemi në dëgjimet tjera buxhetore.


Procesmbajtësi: Elmi Kabashi





Republika Kosova

Republic of Kosovo



Opština Skenderaj

Municipality of Skenderaj

Lista e pjesëmarrësve në dëgjimet buxhetore publike me qytetarë për KAB 2026-2028

Dëgjimi buxhetor në Bashkësinë Lokale të Qirezit

E martë, 03 Qershor 2025, 15:00 SHFMI "Dëshmorët e Qyqavicës", Qirez

[illegible]